

Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu i Kosovës – KOSTT Sh. A.

Adresa : Rruga: Isa Boletini Nr.39, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Personi Kontaktues : Shyqeri Morina, Menaxher i Sektorit për Administrim dhe Zhvillim të Tregut

E-Mail Adresa: [shyqeri.morina@kostt.com](mailto:shyqeri.morina@kostt.com)

## FTESË PËR TENDER

### PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË REZERVAVE PËR RESTAURIMIN E FREKUENCËS

1. **Përshkrim i shkurtër i procedurës së përzgjedhjes,** Sipas Ligjit për Energjinë Elektrike, KOSTT menaxhon dhe operon me sistemin e transmetimit të energjisë elektrike të Kosovës.

Me qëllim të operimit stabil dhe të besueshëm të sistemit elektroenergjetik, KOSTT është i obliguar të sigurojë shërbimet ndihmëse, pjesë e së cilës është Rezerva për Restaurimin e Frekuencës (FRR). KOSTT është i obliguar të bëjë prokurimin për këto shërbime ndihmëse në tregun e energjisë elektrike nga ofruesit e shërbimeve, të cilët i plotësojnë kushtet administrative dhe teknike të ofrojnë shërbimin e Rezervës për Restaurimin e Frekuencës, në pajtim me Procedurën për Tregtimin e Energjisë të miratuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë.

KOSTT fton palët e interesuara, që janë të kyçura në Zonën LFC KOSTT dhe i plotësojnë kushtet për ofrimin e shërbimeve të Rezervës për Restaurimin e Frekuencës, të marrin pjesë në tenderin e organizuar nga KOSTT për ofrimin e shërbimit të Rezervës për Restaurimin e Frekuencës (FRR). Tenderi për ofrimin e shërbimeve të Rezervës për Restaurimin e Frekuencës do të organizohet në tre Lote:

Lot 1: Ofrimin e shërbimeve të Rezervës Automatike për Restaurimin e Frekuencës (aFRR) të rregullimit ngritës me kapacitet 12MW dhe të rregullimit zbritës me kapacitet 12MW.

Lot 2: Ofrimin e shërbimeve të Rezervës Manuale për Restaurimin e Frekuencës (mFRR) të rregullimit ngritës me kapacitet në brezin mes 10MW dhe 67MW.

Lot 3: Ofrimin e shërbimeve të Rezervës Manuale për Restaurimin e Frekuencës (mFRR) të rregullimit zbritës me kapacitet në brezin mes 10MW dhe 90MW.

Palët e interesuara mund të kërkojnë tender dosjen nga personi kontaktues, e cila përbëhet nga:

- a) KOSTT – Kushtet e Përgjithshme për Prokurimin e Shërbimeve të Rezervës për Restaurimin e Frekuencës;

- b) KOSTT – Shpjegimet për Kontratat e Shërbimeve të Rezervës për Restaurimin e Frekuencës dhe Udhëzimet Tenderuese;
- c) KOSTT – Kriteret për Vlerësimin e Ofertave për Shërbimet e Rezervës për Restaurimin e Frekuencës;
- d) KOSTT – Forma për Dorëzimin e Ofertave për Ofrimin e Shërbimeve të Rezervës për Restaurimin e Frekuencës;
- e) KOSTT – Shablloni i Kontratës për Shërbimet e Rezervës për Restaurimin e Frekuencës.

Palët e interesuara mund të dorëzojnë ofertën e tyre për Lotet që konsiderojnë se mund të ofrojnë shërbim (për një, dy apo të tre Llotet).

Oferta duhet të dorëzohet në një zarf me shënimin:

**“Oferta për Rezervën për Restaurimin e Frekuencës (FRR)-KOSTT-(Shënohen Lotët për të cilat është dhënë ofertë)”**, dhe shënohet emri i subjektit dhe adresa e të cilit e dorëzon ofertën – Zarfi Nr.1.

Në Zarfin Nr. 1 vendosen zarfe të veçanta:

- Zarfi me Kushtet Teknike dhe Administrative, i cili përmban dokumentet e kërkuara në të cilin shënohet **“Oferta për Rezervën për Restaurimin e Frekuencës (FRR)-KOSTT-Kushtet teknike dhe administrative”** dhe emri i subjektit dhe adresa e të cilit e dorëzon ofertën;
- Zarfet me Oferta Komerciale me çmimet përkatëse për secilin Llot veç e veç, në të cilët shënohet **“Oferta për Rezervën për Restaurimin e Frekuencës (FRR)-KOSTT-(Shënohet Lloti përkatës për të cilën dorëzohet oferta komerciale)-Oferta Komerciale”** dhe emri i subjektit dhe adresa e të cilit e dorëzon ofertën sipas *“Formës për Dorëzimin e Ofertave për Ofrimin e Shërbimeve të Rezervës për Restaurimin e Frekuencës për Lotin përkatës”*.

Pala, që nuk i plotëson kushtet teknike dhe administrative në përputhje me Kushtet e Përgjithshme për Prokurimin e Shërbimeve të Rezervës për Restaurimin e Frekuencës (FRR) do të diskualifikohet dhe pala do të njoftohet për arsyet e diskualifikimit para datës së caktuar për hapjen e ofertave komerciale. Nëse pala diskualifikohet, Oferta komerciale e palës përkatëse nuk do të hapet.

Pala, e cila diskualifikohet ka të drejtë të paraqes ankesë me shkrim për shkeljen eventuale, përmes e-mailit tek KOSTT, brenda 24 orësh nga momenti i njoftimit nga KOSTT.

Në këtë ankesë, ankimesi duhet të paraqes emrin dhe adresën, referimin për procedurën konkrete, ku ka marrë pjesë, bazën ligjore dhe përshkrimin e shkeljes së pretenduar.

Hapja e ofertave komerciale të palëve të kualifikuara do të jetë publike dhe palët e interesuara kanë të drejtë të marrin pjesë në ceremoni, ku do të bëhet radhitja e ofertave nga oferta më e lirë.

KOSTT mundet që në çdo kohë deri në lidhjen e kontratave për ofrimin e shërbimeve të Rezervave për Restaurimin e Frekuencës (FRR) të anulojë pjesërisht ose tërësisht tenderin/ftesën për oferta për FRR, dhe palët ofertuese me dorëzimin e ofertës pranojnë dhe njohin këtë të drejtë të KOSTT-it.

2. **Afatet kohore,** Datat kyçe për këtë xhiro të tenderit janë dhënë në tabelë:

|   |   |
|---|---|
| Afati i fundit për dorëzimin e shprehjes së interesit   | 27.07.2020  |
| Afati i fundit për dorëzimin e tenderit   | 06.08.2020, deri në ora 16:00                                     |
| Njoftimi i palëve për kualifikim  | 12.08.2020  |
| Dorëzimi i ankesave nga palët e diskualifikuar  | 13.08.2020  |
| Përgjigje në ankesat e palëve   | 17.08.2020  |
| Hapja e pjesës komerciale të tenderëve të palëve të kualifikuara                                    | 19.08.2020  |
| Njoftimi i rezultateve të tenderit  | 31.08.2020  |
| Afati i fundit për nënshkrimin e Marrëveshjes për Shërbimin e Rezervës për Restaurimin e Frekuencës | 16.09.2020, në ora 10:00  |
| Data indicative e fillimit të ofrimit të shërbimit  | 01.10.2020, në ora 00:00, apo sipas njoftimit me shkrim nga KOSTT |

Dokumentet e nënshkruara duhet të dorëzohen në KOSTT me shkrim nëpërmes postës ose të dorëzohen në kopje fizike në selinë e KOSTT-it në adresën: Operator Sistemi Transmisioni dhe Tregu – KOSTT sh.a., Rr. Isa Boletini, Nr. 39. 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, para afatit të fundit për dorëzimin e tenderit.

Për informata shtesë dhe pyetje sqaruese palët mund të adresojnë e-mail te: Shyqeri Morina, përmes e-malit: [shyqeri.morina@kostt.com](mailto:shyqeri.morina@kostt.com), në kopje, cc: [skender.gjonbalaj@kostt.com](mailto:skender.gjonbalaj@kostt.com)

Nuk lejohet dhe nuk pranohet asnjë komunikim telefonik ndërmjet palëve dhe zyrtarëve të KOSTT-it lidhur me “Ofertat për Rezerva për Restaurimin e Frekuencës (FRR)-KOSTT”.

Shënim: Të gjitha informatat dhe dokumentacioni i hartuar nga KOSTT dhe të pranuar nga palët përkatëse në këtë tender janë pronësi intelektuale e KOSTT sh.a.